



RELACION

për projektvendimin

“Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë:

- Në nenin 22, parashikon kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje;
- Në nenin 23 përcakton procedurat që do ndiqen për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe objektin e vendimmarrjes në lidhje me përdorimin e sistemeve apo pajisjeve teknologjike;
- Në nenin 179, pika 1, përcakton se në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021 identifikimi elektronik do të shtrihet në 100 për qind të votuesve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për marrjen e masave për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat sipërcituar, në ushtrim të kompetencave të tij përcaktuar në nenin 19 pika 2, të Kodit Zgjedhor, së bashku me Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, në bashkëushtim të të drejtave të barabarta sipas përcaktimeve të nenit 14, pika 2, nxorën Urdhrin nr.82, datë 12/10/2020 “Për ngritjen e Grupit të Punës “Për Vlersimin e Sistemeveve apo Pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit””.

Grupi i Punës, i drejtuar nga Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përmbushje të detyrave të përcaktuara në Urdhrin e sipërcituar, hartoi raportin “Mbi implemetimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhje, karakteristikat teknike të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit”.

Raporti i grupit të punës paraqet :

- ✓ Propozimin për përdorimin e Pajisjeve Elektronike të Identifikimit (PEI) të cilat do vendosen në çdo qendër votimi që në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021;
- ✓ karakteristikat teknike që duhet të përmbushin pajisjet/sistemet që do të përdoren për identifikimin elektronik të votuesve, dhe të sigurive që ato duhet të garantojnë;


Përzgjedhja mbi bazë analize dhe vlerësimi është paraqitur në mënyrë shteruese në Raport për të gjithë aspektet, ku ndër më kryesoret evidentohen:

- Sistemi Elektronik i Identifikimit të votuesve duhet të operojë në pajisje dhe në rrjet të dedikuar (të mbyllur) në ambientet e KQZ-së. Sistemi duhet të ketë këto karakteristika:
 - të jetë i paaksesueshëm nga jashtë;
 - pas procesit të votimit të mundësojë qendërzimin (hedhjen) e të dhënave në mënyrë të sigurt nga Pajisjet Elektronike të Identifikimit;
 - të mundësojë kryqëzimin (kontrollin) e të dhënave biometrike.
- Pajisja Elektronike e Identifikimit duhet të jetë një pajisje plotësisht e integruar pa komponentë të jashtëm e cila mund të transportohet dhe të vendoset në punë lehtësisht.
- Të gjitha Pajisjet Elektronike të Identifikimit do të kenë të njëjtën listë dhe do të konfigurohen si pajisje të QV-ve ku ndodhen me anë të kodeve përkatëse vetëm në momentin e hapjes së procesit të votimit.
- Çdo Pajisje Elektronike e Identifikimit do të përmbajë regjistrin elektronik të zgjedhësve i cili përmban listën e zgjedhësve me të dhënat e identifikimit të çdo zgjedhësi.
- Të dhënat e identifikimit të zgjedhësve ruhen dhe përpunohen sipas standardeve më të larta të sigurisë në memorien e Pajisjes Elektronike të Identifikimit dhe të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për ruajtjen dhe integritetin e të dhënave personale dhe biometrike si dhe atyre të pjesëmarrjes në votim.
- Pajisja Elektronike e Identifikimit duhet të regjistrojë rastin e identifikimit manual.
- Pajisja Elektronike e Identifikimit do të verifikojë nëse zgjedhësit i lejohet të votojë në atë QV dhe të shfaqë në pajisje të gjithë të dhënat e identifikimit si dhe foton e zgjedhësit.
- Pajisja Elektronike e Identifikimit duhet të identifikojë dhe regjistrojë çdo tentativë për votim të dyfishtë dhe/ose në vend të zgjedhësve të tjerë.

Në nenin 179, pika 3, të Kodit Zgjedhor përcakohet se procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve dhe implementimin e teknologjisë që do të përdoret në zgjedhje do të kryhen sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik, me një nga procedurat më afatshkurtra që lejon ky ligj për këtë prokurim.

Duke vlerësuar kohën në dispozicion, KQZ mund të aplikojë "procedurën me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës", e parashikuar nga neni 33, pika 2, gërma "c" e ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar.

NËNKOMISIONERI
Lealba PELINKU



KOMISIONERI
Ilirjan CELIBASHI

